



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 66 Prot

Tiranë, më 12.12. 2011

VENDIM Nr. 9 dt. 09.12.2011

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 09.12.2011, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI:

Lidhur me:

I. Shqyrtimi i rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

- Propozimet e anëtarëve dhe drejtorive, për ndryshime në rregullore, ti përcillen me shkrim IMK, e cila do të bëjë përmbledhjen zyrtare dhe drafti të diskutohet në mbledhjen e radhës së KKR.

Lidhur me:

II. Shqyrtimi i materialit mbi shpalljen e Zonave mbrojtëse të kishave të Voskopojes.

- Të plotësohet materiali me dokumentacion fotografik dhe të ridiskutohet në KKR.

Lidhur me:

III. Diskutimi i projekteve në pritje për financim.

1. **Miratohet:** Restaurime e mirëmbajtje në qendrën historike, Berat. (Paketë mirëmbajtje).
2. **Miratohet:** Ndërhyrje konservuese në mozaikët e Trichonch Domus, Butrint (mozaiku i ambientit XVI-së).

3. **Miratohet:** Ndërhyrje konservuese në mozaikun e banesës romake Sektori G-Apolloni.
4. **Miratohet:** Ndërhyrje konservuese në mozaikët e nikeve të fontanës së gjimnazit, Butrint.
(Të bëhet një rrethim për mbrojtjen e mozaikut).

Lidhur me:

IV. Diskutimi i kërkesave për shpallje monument kulture.

Miratohen të dy kërkesat e mëposhtme për shpallje monument kulture.

1. Kompleksi Kishë - qelë, "Ndre Mjeda", famullia e Kuklit, Komuna Bushat, Shkodër.
2. Kërkesë për shpallje monument kulture dhe restaurim të xhamisë së vjetër në qytetin e Leskovikut.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R
ALDO BUMÇI**



**SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE**

